

Para	SKK 14 “TRAJTIMI KONTABËL I INVESTIMEVE NË PJESËMARRJE DHE SIPËRMARRJE TË PËRBASHKËTA” – PËRDITËSUAR (2023)
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 14 <i>Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta</i> (SKK 14), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga ministri përgjegjës për financat, është të vendosë rregullat e kontabilizimit dhe të paraqitjes së pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përkruhen në Ligjin për kontabilitetin.
2	SKK 14 është i krahasueshëm me Seksionin 14 “ <i>Investimet në pjesëmarrje</i> ” dhe Seksionin 15 “ <i>Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta</i> ” të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM-të (2015). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2015) është dhënë në paragrafin 37. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 14 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë së njësisë ekonomike raportuese, siç kërkohet në Ligjin për kontabilitetin.
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 64 deri 68 të SKK 1.
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Ky standard zbatohet për: a) trajtimin kontabël të pjesëmarrjeve në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe në pasqyrat financiare të veçanta të një investitori që nuk është një shoqëri mëmë, por që ka një investim në një ose më shumë pjesëmarrje. Paragrafët 6-12 përcaktojnë kërkesat për trajtimin kontabël të pjesëmarrjeve në pasqyrat financiare të veçanta; b) për trajtimin kontabël të sipërmarrjeve të përbashkëta në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe në pasqyrat financiare të veçanta të një investitori që nuk është një shoqëri mëmë, por që ka një interes sipërmarrës në një ose më shumë sipërmarrje të përbashkëta. Paragrafët 14-28 përcaktojnë kërkesat për trajtimin kontabël të interesit të një investitori në një sipërmarrje të përbashkët në pasqyrat financiare të veçanta.
	PËRKUFIZIMET KRYESORE
5	Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore, të përdorur në këtë standard: <u>Ndikimi i ndjeshëm</u> është aftësia për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve, në lidhje me politikat financiare dhe të shfrytëzimit të njësisë ku investohet, por jo kontrolli mbi këto vendime. <u>Pjesëmarrja</u> është njësia, mbi të cilën një investitor ka një influencë të ndjeshme, por që nuk është njësi e kontrolluar nga investitori. <u>Sipërmarrja e përbashkët</u> është një marrëveshje kontraktuale, ku dy ose më shumë palë marrin përsipër një aktivitet ekonomik, i cili është nën kontroll të përbashkët. <u>Njësia mëmë</u> është njësia që zotëron një ose më shumë njësi të kontrolluara. <u>Interesi i pakicës</u> është pjesa e fitimit (humbjes) dhe e aktiveve neto të një njësie të kontrolluar, e cila u takon atyre pjesëve të kapitalit, të cilat nuk zotërohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (nëpërmjet njësive të kontrolluara) nga njësia mëmë. <u>Një biznes</u> është një tërësi veprimtarish të integruara, të kryera e të drejtuara me qëllimin e arritjes së përfitimit të::: a) një kthimi/fitimi për investitorët; b) kostove më të ulëta ose përfitime të tjera ekonomike.
	INVESTIMET NË PJESËMARRJE
	Pjesëmarrja
6	Një pjesëmarrje është një njësia ekonomike, qoftë dhe e paorganizuar juridikisht si p.sh shoqëri e thjeshtë, mbi të cilën investitori ka ndikim të rëndësishëm, e cila nuk është as njësia e kontrolluar dhe as interes në një sipërmarrje të përbashkët.

7	Në përputhje me këtë Standard, pjesëmarrjet janë të gjitha ato njësi mbi të cilat investitori ka një ndikim të rëndësishëm në politikat e saj financiare dhe të shfrytëzimit, por nuk i kontrollojnë ato. Ndikimi i rëndësishëm presupozohet se ekziston kur investitori zotëron në mënyrë direkte ose të tërthortë, nëpërmjet shoqërive të kontrolluara, më shumë se 20% të së drejtës votuese të pjesëmarrjes, përveç rasteve përjashtimore kur mund të tregohet qartë se një zotërim i tillë nuk përbën ndikim të ndjeshëm. Ndikimi i ndjeshëm mund të ekzistojë edhe nëse zotërohen më pak se 20%, kur një ndikim i tillë mund të demonstrohet qartë. Një investitor nuk përjashtohet të ketë ndikim të ndjeshëm edhe pse një investitor tjetër mund të ketë një pronësi të konsiderueshme ose shumicën.
	Matja - zgjedhja e politikës kontabël
8	Një investitor do të trajtojë të gjitha investimet e tij në pjesëmarrje duke përdorur njërin prej modeleve në vijim: <ul style="list-style-type: none"> - modelin e kostos në paragrafët 9 dhe 10; - modelin e kapitalit neto në paragrafin 11; - modelin e vlerës së drejtë në paragrafin 12.
	Modeli i kostos
9	Një investitor mat investimet e tij në pjesëmarrje me kosto pakësuar me ndonjë humbje nga zhvlerësimi i akumuluar i njohur në përputhje me <i>SKK 3 Instrumentet Financiare</i> .
10	Investitori njihet dividendët dhe shpërndarjet e tjera të marra nga investimi si të ardhura, pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e akumuluar të pjesëmarrjes para ose pas datës së blerjes.
	Modeli i kapitalit neto
11	Sipas modelit të kapitalit neto, një investim në pjesëmarrje njihet fillimisht me çmimin e transaksionit (duke përfshirë kostot e transaksionit) dhe rregullohet më pas, për të pasqyruar pjesën e investitorit në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjes, si më poshtë: <p>(a) <i>Shpërndarjet dhe rregullimet e tjera në vlerën kontabël</i>. Shpërndarjet e marra nga investimi në pjesëmarrje ulin vlerën kontabël të investimit. Rregullimet në vlerën kontabël mund të jenë të nevojshme si pasojë e ndryshimeve në kapitalin e pjesëmarrjes, si rezultat i zërave që prekin kapitalin (p.sh pagesa e dividendëve, rritja ose pakësimi i kapitalit themeltar, por duke përjashtuar riklasifikimet brenda kapitalit, si p.sh krijimi i rezervave ligjore);</p> <p>(b) <i>Të drejtat votuese të mundshme</i>. Edhe pse në përcaktimin nëse ekziston ose jo ndikim i ndjeshëm merren në konsideratë të drejtat votuese të mundshme, një investitor mat pjesën e tij në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjes dhe pjesën e tij në ndryshimet në kapitalin e pjesëmarrjes mbi bazën e interesave të pronësisë aktuale. Në këtë matje nuk do të pasqyrohet ushtrimi ose konvertimi i mundshëm i të drejtave votuese të mundshme;</p> <p>(c) <i>Emri i mirë i nënkuptuar dhe rregullimet e vlerës së drejtë</i>. Menjëherë me kryerjen e investimit në një pjesëmarrje, një investitor do të kontabilizojë çdo diferencë (qoftë pozitive ose negative) midis kostos së investimit dhe pjesës së investitorit në vlerat e drejta të aktiveve neto të identifikueshme të pjesëmarrjes sipas SKK 9. Pas kryerjes së investimit, investitori do të rregullojë pjesën e tij në fitimet apo humbjet e pjesëmarrjes për amortizimin shtesë të aktiveve të amortizueshme të pjesëmarrjes (duke përfshirë edhe emrin e mirë) në bazë të tejkallimit të vlerave të tyre të drejta mbi vlerat kontabël të tyre në datën e kryerjes së investimit;</p> <p>(ç) <i>Zhvlerësimi</i>. Nëse ka tregues se një investim në një pjesëmarrje mund të jetë zhvlerësuar, një investitor do të testojë për zhvlerësim vlerën kontabël të investimit, si një aktiv i vetëm, në përputhje me SKK 5. Çdo emër i mirë i përfshirë si pjesë e vlerës kontabël të investimit në pjesëmarrje nuk testohet veças për zhvlerësim por, si pjesë e testit për zhvlerësim të investimit si një i tërë;</p> <p>(d) <i>Transaksionet e investitorit me pjesëmarrjet</i>. Në qoftë se një pjesëmarrje kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto, investitori do të eliminojë fitimet dhe humbjet e përcaktuara që rezultojnë nga transaksionet nga poshtë-lart (pra nga pjesëmarrja tek investitori) dhe nga lart-poshtë (nga investitori tek pjesëmarrja) në masën e interesit të investitorit në pjesëmarrje. Humbjet e përcaktuara për transaksione të tilla mund të evidentojnë një zhvlerësim të aktivitetit të transferuar;</p> <p>(dh) <i>Data e pasqyrave financiare të pjesëmarrjes</i>. Kur zbatohet modeli i kapitalit neto, investitori duhet të përdorë pasqyrat financiare të pjesëmarrjes të të njëjtës datë me atë të pasqyrave financiare të tij, me përjashtim kur kjo është e pamundur. Në qoftë se është e pamundur një gjë e tillë, investitori duhet të përdorë pasqyrat financiare më të fundit të pjesëmarrjes që ai ka të disponueshme, me rregullimet e bëra për efektet e çdo transaksioni të rëndësishëm apo ngjarjeve që ndodhin midis dy periudhave kontabël;</p> <p>(e) <i>Politikat kontabël të pjesëmarrjes</i>. Nëse pjesëmarrja përdor politika kontabël, që ndryshojnë nga ato të investitorit, investitori do të rregullojë pasqyrat financiare të pjesëmarrjes për të pasqyruar politikat e tij kontabël me qëllim zbatimin e modelit të kapitalit neto, përveçse kur një gjë e tillë është e pamundur;</p> <p>(f) <i>Humbjet më të larta se investimi</i>. Nëse pjesa e humbjes së investitorit në një pjesëmarrje është e barabartë ose tejkallon shumën e investimit të tij në pjesëmarrje, investitori do të ndërpresë njohjen e pjesës së tij në humbjet e ardhshme. Pasi interesi i investitorit është ulur në zero, investitori duhet të njohë humbje shtesë</p>

	<p>nëpërmjet një provizioni (shih SKK 6 <i>Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara</i>) vetëm në atë masë që investitori është përfshirë në detyrime ligjore ose konstruktive, ose ka bërë pagesa në emër të pjesëmarrjes. Nëse pjesëmarrja më pas raporton fitime, investitori do të rifillojë të njohë pjesën e tij në këto fitime vetëm pasi kjo pjesë të jetë e barabartë me pjesën e humbjeve të panjohura ;</p> <p>(g) <i>Ndërprerja e modelit të kapitalit</i>. Një investitor do të ndërpresë së përdoruri metodën e kapitalit nga data që ka mbaruar ndikimi i ndjeshëm;</p> <p>--(g.i) Në qoftë se pjesëmarrja bëhet një njësi e kontrolluar ose sipërmarrje e përbashkët, investitori do të rrimasë interesin e kapitalit të tij të mbajtur më parë me vlerën e drejtë dhe do të njohë fitimin ose humbjen neto që rezulton, në qoftë se ka, në fitim ose humbje;</p> <p>--(g.ii) Në qoftë se investitori humb ndikimin e ndjeshëm mbi një pjesëmarrje si rezultat i një shitje të plotë ose të pjesshme, ai do t'a çregjistrojë pjesëmarrjen dhe do të njohë në fitim apo humbje diferencën mes (a) dhe (b):</p> <p>(a) shumës së të ardhurave të marra plus vlerën e drejtë të çdo interesi të mbetur; dhe</p> <p>(b) vlerës kontabël të investimit në pjesëmarrje në datën që ka humbur ndikimi i ndjeshëm.</p> <p>Pas kësaj, investitori do të bëjë trajtimin kontabël për ndonjë interes të mbetur sipas SKK 3 <i>Instrumentet financiare</i>;</p> <p>--(g.iii) Në qoftë se investitori humb ndikimin e ndjeshëm për arsye të ndryshme nga shitja e pjesshme e investimit të tij, investitori do t'a konsiderojë vlerën kontabël të investimit në këtë datë si një bazë për koston e re dhe do ta kontabilizojë investimin sipas SKK 3.</p>
	Modeli i vlerës së drejtë
12	Investimi në një pjesëmarrje, në njohjen fillestare, matet me çmimin e transaksionit. Çmimi i transaksionit përjashton kostot e transaksionit. Në çdo datë raportimi, një investitor mat investimet e tij në pjesëmarrje me vlerën e drejtë, me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim ose humbje, sipas kërkesave të paragrafëve 55 - 60 të SKK 3 <i>Instrumentet financiare</i> . Një investitor që ka zgjedhur të zbatojë modelin e vlerës së drejtë për investimet në pjesëmarrje, për rastet kur është praktikisht e pamundur të matet vlera e drejtë e besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, do të përdorë modelin e koston.
	Paraqitja e pasqyrave financiare
13	Një investitor duhet të klasifikojë investimet në pjesëmarrje si aktive afatgjata.
	INVESTIMET NË SIPËRMARRJET E PËRBASHKËTA
	Sipërmarrja e përbashkët
14	Kontrolli i përbashkët është ndarja, sipas një marrëveshjeje kontraktuale, e kontrollit mbi një aktivitet ekonomik, dhe ekziston vetëm kur vendimet strategjike financiare dhe të shfrytëzimit që lidhen me aktivitetin kërkojnë pëlqimin unanimit të palëve që ndajnë kontrollin (sipërmarrësit).
15	Një sipërmarrje e përbashkët është një marrëveshje kontraktuale sipas të cilës dy apo më shumë palë ndërmarrin një veprimtari ekonomike që është subjekt i kontrollit të përbashkët. Sipërmarrjet e përbashkëta mund të marrin formën e aktiviteteve të kontrolluara së bashku, të aktiveve të kontrolluara së bashku, ose të njësisive të kontrolluara së bashku.
	Aktivitetet e kontrolluara bashkërisht
16	Funksionimi i disa sipërmarrjeve të përbashkëta kërkon përdorimin e aktiveve dhe burimeve të tjera të sipërmarrësve dhe jo krijimin e një korporate, shoqërie të thjeshtë ose të një njësie ekonomike tjetër, apo të një strukture financiare që është e ndarë nga vetë sipërmarrësit. Çdo sipërmarrës përdor aktivet afatgjata materiale dhe inventarët e vet. Ai gjithashtu kryen shpenzimet e veta, ka detyrimet e veta dhe siguron financimet e tij, të cilat krijojnë detyrimet e tij. Aktivitetet e sipërmarrjes së përbashkët mund të kryhen nga punonjësit e sipërmarrësit përbri aktiviteteve të ngjashme të sipërmarrësit. Marrëveshja e përbashkët e sipërmarrjes zakonisht përbën mjetin me anën e të cilit të ardhurat nga shitja e produktit të përbashkët dhe çdo shpenzim i bërë në mënyrë të përbashkët ndahen midis sipërmarrësve.
17	Në lidhje me interesat e tij në aktivitetet e kontrolluara bashkërisht, një sipërmarrës do të njohë në pasqyrat financiare të tij:
	(a) aktivet që ai kontrollon dhe detyrimet që i lindin; dhe
	(b) shpenzimet që ai bën dhe pjesën e tij të të ardhurave që fiton nga shitja e mallrave ose shërbimeve nga sipërmarrja e përbashkët.
	Aktivitetet e kontrolluara bashkërisht
18	Disa sipërmarrje të përbashkëta kërkojnë kontrollin e përbashkët dhe shpesh pronësinë e përbashkët, nga sipërmarrësit të një ose më shumë aktiveve të kontribuara, ose të fituara dhe të dedikuara për qëllimin e sipërmarrjes së përbashkët .
19	Në lidhje me interesin e tij në një aktiv të kontrolluar bashkërisht, një sipërmarrës njeh në pasqyrat financiare:
	(a) pjesën e tij në aktivet e kontrolluara bashkërisht, të klasifikuara sipas natyrës së tyre;
	(b) të gjitha detyrimet që ai ka krijuar;
	(c) pjesën e tij në çdo detyrim të krijuar së bashku me sipërmarrësit e tjerë në lidhje me sipërmarrjen e përbashkët;
	(d) të ardhurat nga shitja (ose përdorimi) e pjesës së tij në produktet (ose aktivet) e sipërmarrjes së përbashkët, së bashku me pjesën e tij në çdo shpenzim të bërë nga sipërmarrja e përbashkët;

	(e) shpenzimet që ai ka kryer në lidhje me interesin e tij në sipërmarrjen e përbashkët.
	Njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht
20	Një njësi ekonomike e kontrolluar bashkërisht është një sipërmarrje e përbashkët që përfshin krijimin e një korporate, shoqërie të thjeshtë ose të një njësie ekonomike tjetër në të cilën çdo pjesëmarrës ka një interes. Njësia ekonomike vepron në të njëjtën mënyrë si njësitë ekonomike të tjera, përveç se ka një marrëveshje kontraktuale midis sipërmarrësve që vendos kontroll të përbashkët mbi veprimtarinë ekonomike të njësisë.
	Matja – zgjedhja e politikës kontabël
21	Një investitor do të trajtojë të gjitha investimet e tij në sipërmarrjet e përbashkëta duke përdorur një prej modeleve në vijim: <ul style="list-style-type: none"> - modelin e kostos në paragrafin 22 dhe 23; - modelin e kapitalit neto në paragrafin 24; - modelin e vlerës së drejtë në paragrafin 25.
	Modeli i kostos
22	Një sipërmarrës mat investimet e tij në njësitë ekonomike bashkërisht të kontrolluara me modelin e kostos, pra kosto e pakësuar me ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi i njohur në përputhje me SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i> .
23	Investitori njej shpërndarjet e marra nga investimi si të ardhura, pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e akumuluar para ose pas datës së blerjessë njësies ekonomike bashkërisht të kontrolluar, .
	Modeli i kapitalit neto
24	Një sipërmarrës, mat investimin e tij në njësinë ekonomike bashkërisht të kontrolluar, me modelin e kapitalit neto duke përdorur procedurat e dhëna në paragrafin 11 (duke zëvendësuar, aty ku përdoret, 'ndikim i ndjeshëm' me 'kontroll i përbashkët').
	Modeli i vlerës së drejtë
25	Investimi në një njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht, në njohjen fillestare, matet me çmimin e transaksionit. Çmimi i transaksionit përjashton kostot e transaksionit. Në çdo datë raportimi, një sipërmarrës do të masë investimet e tij në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht me vlerën e drejtë, me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim ose humbje, duke përdorur udhëzimin e matjes së vlerës së drejtë në paragrafët 55-60 të SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i> .. Një investitor që ka zgjedhur të zbatojë modelin e vlerës së drejtë për investimet në njësi ekonomike të kontrolluara bashkërisht, për rastet kur është praktikisht e pamundur të matet vlera e drejtë e besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, do të përdorë modelin e kostos.
	Transaksionet midis një sipërmarrësi dhe një sipërmarrjeje të përbashkët
26	Kur një sipërmarrës jep kontribute ose i shet aktivet tek sipërmarrja e përbashkët, njohja e çdo pjese të fitimit ose humbjes nga transaksioni do të pasqyrojë përmbajtjen e transaksionit. Për aq kohë sa aktivet mbahen nga sipërmarrja e përbashkët, dhe sipërmarrësi i ka transferuar sipërmarrjes së përbashkët rreziqet dhe përfitimet më të rëndësishme të lidhura me pronësinë e aktiveve, sipërmarrësi njej vetëm atë pjesë të fitimit ose humbjes që i atribuohet interesave të sipërmarrësve të tjerë. Sipërmarrësi njej shumën e plotë të çdo humbjeje atëherë kur kontributi ose shitja evidenton një humbje nga zhvlerësimi.
27	Kur një sipërmarrës blen aktive nga një sipërmarrje e përbashkët, sipërmarrësi nuk njej pjesën e tij në fitimet e sipërmarrjes së përbashkët nga transaksioni derisa ai (sipërmarrësi) t'ia rishesë aktivet një pale të pavarur. Një sipërmarrës do të njohë pjesën e tij në humbjet që rezultojnë nga këto transaksione në të njëjtën mënyrë si dhe fitimet, përveç se humbjet do të njihen menjëherë atëherë kur ato përfaqësojnë një humbje nga zhvlerësimi.
	Nëse investitori nuk ka kontroll të përbashkët
28	Investitori në një sipërmarrje të përbashkët që nuk ka kontroll të përbashkët do ta kontabilizojë investimin në përputhje me SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i> ose, nëse ai ka ndikim të ndjeshëm në sipërmarrjen e përbashkët, në përputhje me paragrafët 6-12 të këtij Standardi.
	SHËNIMET SHPJEGUESE
	Investimet në pjesëmarrje
29	Një investitor në një pjesëmarrje do të japë informacionet shpjeguese në vijim: <ul style="list-style-type: none"> (a) politikën e tij kontabël për investimet në pjesëmarrje; (b) vlerën kontabël neto të investimeve në pjesëmarrje. (c) vlerën e drejtë të investimeve në pjesëmarrje të mbajtura me modelin e kapitalit neto.
30	Për investimet në pjesëmarrje, të kontabilizuara sipas modelit të kostos, një investitor do të japë informacion shpjegues për shumën e dividendëve dhe shpërndarjet e tjera të njohura si të ardhura.

31	Për investimet në pjesëmarrje, të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto, një investitor do të japë informacion shpjegues veçmas për pjesën e vet në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjeve dhe pjesën e tij në aktivitetet e ndërprera të pjesëmarrjeve, nëse ka të tilla.	
32	Për investimet në pjesëmarrje të mbajtura sipas modelit të vlerës së drejtë, një investitor do të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 38-39 të SKK 3 <i>Instrumentet financiare</i> . Nëse një investitor zbaton për çdo pjesëmarrje përjashtimin në paragrafin 12, për kosto apo përpjekje të papërshtatshme, ai duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt, arsyet pse matja me vlerën e drejtë do të kërkojë kosto apo përpjekje të papërshtatshme dhe vlerën kontabël (neto) të investimeve në pjesëmarrjet të trajtuara sipas modelit të koston.	
Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta		
33	Një investitor në një sipërmarrje të përbashkët do të japë informacion shpjegues për: (a) politikën kontabël që ka përdorur në njohjen e interesave të tij në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkarisht, (b) vlerën kontabël neto të investimeve në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkarisht. (c) vlerën e drejtë të investimeve në kontrollin e përbashkët të mbajtura me modelin e kapitalit neto; dhe (ç) shumën totale të angazhimeve të tij në lidhje me sipërmarrjet e përbashkëta, duke përfshirë pjesën e tij në angazhimet e kapitalit që janë bërë së bashku me sipërmarrësit e tjerë, si edhe pjesën e tij të angazhimeve të kapitalit të vetë sipërmarrjeve të përbashkëta.	
34	Për njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht, të kontabilizuara me modelin e kapitalit neto, sipërmarrësi duhet të japë gjithashtu informacione shpjeguese siç kërkohet nga paragrafi 33 për investimet me modelin e kapitalit.	
35	Për njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht, të trajtuara në përputhje me modelin e vlerës së drejtë, sipërmarrësi duhet të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 38 dhe 39 të SKK 3 <i>Instrumentet financiare</i> . Nëse një sipërmarrës zbaton përjashtimin për kosto apo përpjekje të papërshtatshme në paragrafin 25 për çdo njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht ai duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt, arsyet pse matja me vlerën e drejtë do të kërkojë kosto apo përpjekje të papërshtatshme dhe vlerën kontabël (neto) të investimeve në njësinë ekonomike të kontrolluar bashkërisht të trajtuara sipas modelit të koston.	
DATA E HYRJES NË ZBATIM		
36	SKK 14 <i>Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta</i> , përditësuar në vitin 2023, do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 01.01.2025. Kërkesat e SKK 14 (2023) do të zbatohen në prospektivë.	
TABELA KRAHASUESE		
37	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM (2015). Paragrafët janë konsideruar si korresponduese nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje pavarësisht nga fakti që seksionet e referuara mund të kenë ndryshime.	
	Paragrafët e SKK 14	
	Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2015	
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 14.1, Sek 15.1
	Paragrafi 5	Asnjë
	Paragrafi 6	Sek 14.2
	Paragrafi 7	Sek 14.3
	Paragrafi 8	Sek 14.4
	Paragrafi 9	Sek 14.5
	Paragrafi 10	Sek 14.6
	Paragrafi 11	Sek 14.8
	Paragrafi 12	Sek 14.9, Sek 14.10
	Paragrafi 13	Sek 14.11
	Paragrafi 14	Sek 15.2
	Paragrafi 15	Sek 15.3
	Paragrafi 16	Sek 15.4
	Paragrafi 17	Sek 15.5

	Paragrafi 18	Sek 15.6
	Paragrafi 19	Sek 15.7
	Paragrafi 20	Sek 15.8
	Paragrafi 21	Sek 15.9
	Paragrafi 22	Sek 15.10
	Paragrafi 23	Sek 15.11
	Paragrafi 24	Sek 15.13
	Paragrafi 25	Sek 15.14, Sek 15.15
	Paragrafi 26	Sek 15.16
	Paragrafi 27	Sek 15.17
	Paragrafi 28	Sek 15.18
	Paragrafi 29	Sek 14.12
	Paragrafi 30	Sek 14.13
	Paragrafi 31	Sek 14.14
	Paragrafi 32	Sek 14.15
	Paragrafi 33	Sek 15.19
	Paragrafi 34	Sek 15.20
	Paragrafi 35	Sek 15.21
	Paragrafi 36	Asnjë
	Paragrafi 37	Asnjë